

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E DREJTA DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Enver Hasani
Detajet kontaktuese:	enver.hasani@uni-pr.edu
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<p><b><i>E Drejta Diplomatike dhe Konsullore</i></b> është një fushë e së drejtës ndërkombëtare që rregullon praktikën mbarëbotërore të diplomacisë nga shtetet, kombet e ndryshme dhe organizatat ndërkombëtare. Në themel të marrëdhënieve moderne diplomatike – si instrumenti kryesor legal - është Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike e vitit 1961, e cila ofron bazën ligjore ndërkombëtare për veprimet e diplomatëve gjithandej, për shkak të të vetmit fakt, se ajo është ratifikuar gjerësisht nga shumica e shteteve kombëtare.</p> <p>Kjo lëndë në <i>studimet Master</i> ka për qëllim të ofrojë një kuptim të teorisë dhe praktikës së rregullave ligjore të kodifikuara dhe zakonore që qeverisin veprimtarinë e misioneve diplomatike, misioneve konsullore dhe misioneve të përhershme pranë organizatave ndërkombëtare, si dhe aspektet e ndërlihdura që e karakterizojnë veprimtarinë e shërbimeve të jashtme ose të organeve shtetërore të ngarkuara për marrëdhëniet me jashtë.</p> <p>Kjo lëndë, vec të tjerash, ka për qëllim të ofrojë mësimdhënie kërkimore me bazë të detajuar në këtë lëndë, duke marrë një qasje të drejtpërdrejtë në të drejtën diplomatike dhe konsullore ndërkombëtar – që poashtu diskuton aspekte të ndryshme të diplomacisë, e që janë me rëndësi për efektshmërinë e saj.</p> <p>Çështjet që do të diskutohen gjatë gjithë semestrit do të përfshijnë: themelimin ligjor të marrëdhënieve diplomatike, imunitetet diplomatike dhe konsullore, dhe gjithashtu privilegjet, kategoritë e misioneve</p>

	<p>diplomatike dhe konsullore, duke përfshirë edhe pozitën e Kryetarëve të Shteteve dhe atyre të Qeverive në të Drejtën diplomatike.</p> <p>Për më tepër, <i>E drejta konsullore</i> brenda sferës së drejtës diplomatike ndërkombëtare do të mbulohet gjerësisht, sic është azili diplomatik dhe statusi i organizatave ndërkombëtare, duke këtu përfshirë natyrën <i>sui generis</i> të Bashkimit Evropian.</p> <p>Lënda do të jetë me interes për studentët të cilët posedojnë interes të avancuar në të drejtën diplomatike, por edhe ata që kanë kureshtje të theksuar për marrëdhëniet ndërkombëtare.</p>
<p><b>Qëllimet e lëndës:</b></p>	<p>Qëllimet e lëndës janë mbi të gjitha ato të ofrimit të studentëve me njohuri më të thella në fushën e së Drejtës Diplommatike dhe Konsullore – si një nga nën-disiplinat juridike të së Drejtës ndërkombëtare publike.</p> <p>Në mënyrë që studentët t’i përmirësojnë njohuritë e tyre teorike dhe për të zhvilluar aftësinë e tyre për të zgjidhur probleme konkrete praktike, kjo lëndë do të mundësojë përmbushjen e këtij qëllimi – duke analizuar dispozitat përkatëse të traktateve ndërkombëtare dhe jurisprudencën, sidomos praktikën gjyqësore të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.</p>
<p><b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b></p>	<p><i>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët janë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>(1) Të kuptojnë dhe shpjegojnë parimet themelore të artit të të bërit diplomaci, përfshirë origjinat dhe zhvillimin historik të diplomacisë;</li> <li>(2) Të fitojnë bazat e nevojshme teorike për të kuptuar se si dhe pse <i>E drejta diplomatike</i> dhe konsullore ekziston;</li> <li>(3) Të indentifikojnë problemet më kryesore të shume aspekteve ligjore për rregullat që qeverisin politikën, diplomacinë, dhe ligjin në mes të akterëve botëror – aty ku qeveris e drejta diplomatike ndërkombëtare;</li> <li>(4) Të zotërojnë me aftësinë për të punuar me zakonet juridike ndërkombëtare në diplomaci, duke i lejuar trajtimin korrekt të traktateve dhe marrëveshjeve diplomatike, si dhe për të kuptuar parametrat më të gjera ligjore të tyre;</li> <li>(5) Të dallojnë format e veçanta të institucioneve që përfaqësojnë shtetet dhe organizatat ndërkombëtare në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella;</li> <li>(6) Të kuptojnë procesin e krijimit, funksionimit dhe përfundimit të marrëdhënieve diplomatike;</li> </ol>

	(7) Të identifikojnë dhe kuptojnë kushtet ligjore në bazë të të cilave përfaqësuesit diplomatikë dhe konsullorë jetojnë dhe punojnë në shtetin pranues; (8) Të zhvillojnë shkathtësi komunikimi, në të shkruar dhe përmes prezantimeve verbale.		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	2	4
Ushtrime në teren	5	1	5
Kollokfiume,seminare	4	4	16
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	10	2	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet, prezentimet ,etj	2	3	6
<b>Totali</b>			<b>135</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Prezantimi i njohurive themelore teorike përmes ligjëratave, seminareve (analiza e jurisprudencës dhe shembuj të legjislacionit të brendshëm); detyra individuale. Ligjërata, punime seminarike dhe konsultime individuale me studentë.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Do të ketë një provim përfundimtar – pjesa kryesore e vlerësimit – që do të mbulojë materialet e detyrueshme për lexim, si shtesë e asaj që është thënë në ligjërata. Nota do të varet në vlerën prej 60 për qind (%) nga ky provim. Për pjesën tjetër të vlerësimit (40 %), studentët do të kenë: ☑ Një apo dy prezantime gojore dhe mbrojtjen e të njëjtave përpara studentëve, për jo më pak se 15 minuta. Prezantimi do të jetë lidhur me një çështje të trajtuar në këtë lëndë apo për një temë që do të përcaktohet në konsultim me profesorin e lëndës; ☑ Shkrimi dhe dorëzimi i një punimi për të njëjtën çështje (të prezantuar gojarisht), apo ndonjë çështje		

	<p>tjetër (e cilat përcaktohet në marrëveshje me profesorin). Për nga aspekti i formës, punimi duhet të ketë jo më pak se 7 dhe jo më shumë se 10 faqe të kompjuterit, double-spaced, formati 12 Times New Roman.</p> <p>Një minimum prej 55 % është i nevojshëm për notë pozitive kaluese. Inkurajohet pjesëmarrja aktive, përmbytësore dhe e rregullt e studentëve në ligjërata.</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<p>1) Eileen Denza (2008), <i>Diplomatic Law: Commentary on the Vienna Convention on Diplomatic Relations</i>, 3rd ed. (Clarendon Press: Oxford).</p> <p>2) Borut Bohte &amp; Vasilka Sancin (2011) <i>E Drejta Diplomatike dhe Konsullore</i>, Prishtinë, Kolegji Victory.</p>
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>1) Zejnullah Gruda (2009), <i>Manual Diplomatik</i>. Prishtinë;</p> <p>2) Ian Brownlie (2003), <i>Principles of Public International Law</i>. Oxford: Oxford University Press. Chapter 17: "Diplomatic and Consular Relations";</p> <p>3) Luke Lee, John Quigley (2008) <i>Consular Law and Practice</i> (Oxford: Oxford University Press).</p> <p>4) Geoff R. Berridge (2015) <i>Diplomacy: Theory and Practice</i>. Palgrave: Macmillan.</p> <p>5) Andrew F. Cooper, Jorge Heine, Tamesh Thakur (Eds.). 2013. <i>The Oxford Handbook of Modern Diplomacy</i>. Oxford University Press.</p> <p>6) Ludwik Dembinski (1998), <i>The Modern Law of Diplomacy. External missions of states and international organizations</i>. Dordrecht-Boston-Lancaster: Martinus Nijhoff Publishers;</p> <p>7) B.S. Murty (1989), <i>The International Law of Diplomacy. The Diplomatic Instrument and World Public Order</i>. New Haven: New Haven Press, Dordrecht-Boston-London: Martinus Nijhoff Publishers;</p> <p>8) Rene Albrecht - Carrie (1965), <i>A Diplomatic History of Europe Since the Congress of Vienna</i>. London: University Paperbacks.</p> <p><u>Ligje dhe dokumente:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike e vitit 1961;</i></li> <li>• <i>Ligji për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës;</i></li> <li>• <i>Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës;</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës;</i></li> <li>• <i>Ligji për Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplomatike, Konsullore dhe Personelin e Kosovës dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake si dhe personelin e saj;</i></li> <li>• <i>Ligji për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës;</i></li> <li>• <i>Rregullorja për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.</i></li> <li>• <i>Çdo libër nga E Drejta Ndërkombëtare Publike, pjesa mbi të Drejtën Diplomatike dhe Konsullore;</i></li> <li>• <i>Milan Jazbec (2008), Bazat e Diplomacisë. Prishtinë: Kolegji Universitar “Victory”.</i></li> </ul>
<b>Plani i dizajnuar i mësimimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e Parë:</b>	<b>Përmbajtja, organizimi dhe kërkesat e lëndës; metodologjia e mësimdhënies dhe metoda e vlerësimit.</b>
<b>Java e Dytë:</b>	<p><b>EVOLUCIONI HISTORIK I LËNDËS</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (1961)</li> <li>- Nocioni i Diplomacisë</li> <li>- E Drejta e Legacionit</li> <li>- Kodifikimi dhe zhvillimi i saj</li> <li>- Privilegjet dhe Imunitetet Diplomatike – Imuniteti i Pronës</li> <li>- Paprekshmëria e hapësirave të misionit diplomatik</li> <li>- Paprekshmëria e arkivave dhe dokumenteve të misionit.</li> </ul>
<b>Java e Tretë:</b>	<p><b>STRUKTURA E DIPLOMACISË</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>* Themelimi i marrëdhënieve diplomatike</li> <li>* Misioni i përhershëm diplomatik</li> <li>* Zhvillimi i të drejtave mbi privilegjet dhe imunitetet diplomatike</li> <li>* Diplomacia dhe funksionet e saj;</li> <li>* Detyrat e politikës së jashtme;</li> <li>* Funksionet e misionit diplomatik;</li> <li>* Fushëveprimi dhe obligimet e diplomatit;</li> <li>* Karakteristikat e diplomatit;</li> <li>* Kontaktet diplomatike dhe rregullat e komunikimit;</li> <li>* Gjuha diplomatike.</li> </ul>
<b>Java e Katërt:</b>	<p><b>ORGANET QENDRORE TË PËRFAQËSIMIT NË DIPLOMACI</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shefi i Shtetit (Presidenti)</li> <li>• Qeveria (Kryeministri)</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ministri i Puneve të Jashtme</li> <li>• Kushtetuta e Republikës së Kosovës</li> </ul>
<b>Java e Pestë:</b>	<p><b>E DREJTA DIPLOMATIKE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>* Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (KVMD)</li> <li>* E Drejta e Misionit (<i>ius legationis</i>)</li> <li>* Vendosja e marrëdhënieve diplomatike dhe e misioneve të përhershme diplomatike</li> <li>* Misionet diplomatike si organe të shërbimit të jashtëm</li> <li>* Privilegjet dhe imunitetet e misioneve diplomatike</li> <li>* Privilegjet dhe imuniteti i personelit të misioneve (anëtarët)</li> <li>* Personeli diplomatik dhe Shteti pritës</li> <li>* Krijimi dhe përfundimi i një misioni diplomatik</li> <li>* Ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike</li> <li>* Rregullat për misione të veçanta</li> </ul>
<b>Java e Gjashtë:</b>	<p><b>FUNKSIONET E PËRFAQËSUESVE DIPLOMATIK</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>* Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike (1961)</li> <li>* Përfaqësimi dhe negociimi</li> <li>* Raportimi mbi kushtet dhe zhvillimet në Shtetin pranues</li> <li>* Mbrojtja e interesave të shtetit dërgues dhe shtetasve të tij</li> <li>* Promovimi i marrëdhënieve miqësore</li> <li>* Obligimi i mosndërhyrjes në punët e brendshme të shtetit pranues.</li> </ul> <p><b>Klasat dhe Rangu i Udhëheqësve të Misioneve Diplomatike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>* Kori Diplomatik</li> <li>* Emërimi dhe Akreditimi</li> <li>* Lehtësitë në punën e misionit diplomatik <ul style="list-style-type: none"> <li>- Liria e qarkullimit</li> <li>- Liria e komunikimit</li> </ul> </li> <li>* Përfundimi dhe ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike</li> <li>* Shuarja e misionit diplomatik</li> </ul>
<b>Java e Shtatë:</b>	<b>Test mes-semestral (kolokuium)</b>
<b>Java e Tetë:</b>	<p><b>PËRFAQËSIMI I SHTETEVE NË MARRËDHËNIET E TYRE ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE KONFERENCAT NDËRKOMBËTARE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>* Misionet e përhershme të akredituara pranë organizatave ndërkombëtare</li> <li>* Emërimi i përfaqësuesve special</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>* Privilegjet dhe imunitetet e misioneve speciale dhe të anëtarëve të tyre</li> <li>* Paprekshmëria personale</li> <li>* Akreditimi dhe detyrat e misioneve të përhershme</li> <li>* Imuniteti ndaj procedurave gjyqësore</li> <li>* Diplomacia multilaterale</li> <li>* Heqja dorë nga imuniteti.</li> </ul>
<b>Java e Nëntë:</b>	<p><b>PRIVILEGJET DHE IMUNITETET DIPLOMATIKE – IMUNITETI PERSONAL</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>* Imunitetet e përfaqësuesve diplomatike;</li> <li>* Privilegjet e përfaqësuesve diplomatike;</li> <li>* Përfitimi dhe Humbja e privilegjeve dhe imuniteteve diplomatike;</li> <li>* Paprekshmëria e përfaqësuesve diplomatikë;</li> <li>* Personat që gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e plota diplomatike</li> <li>* Azili diplomatik</li> <li>* Valixhja diplomatike</li> <li>* Personat që gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e kufizuara diplomatike.</li> <li>* Imuniteti në lëmin penal</li> <li>* Imuniteti civil</li> <li>* Imuniteti fiskal</li> </ul>
<b>Java e Dhjetë:</b>	<p><b>PROTOKOLLI DHE CEREMONIALI DIPLOMATIK</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>* Preseansi</li> <li>* Titujtë dhe mënyra e të drejtuarit</li> <li>* Takimet zyrtare</li> <li>* Ceremonialet shtetërore</li> <li>* Zia zyrtare</li> <li>* Flamujt</li> <li>* Dhuratat dhe suveniret</li> <li>* Gjuha diplomatike</li> <li>* Format e leterkëmbimit me shkrim</li> <li>* Demonstratat</li> </ul>
<b>Java e Njëmbëdhjetë:</b>	<p><b>SANKSIONET NË TË DREJTËN DIPLOMATIKE</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>* Aplikimet kufizuese në baza të reciprocitetit (retorzioni)</li> <li>* Ndalimi i kundërmasave (represaljeve/hakmarrjeve) në të drejtën diplomatike;</li> <li>* Deklarimi ‘persona non grata’ i përfaqësuesit diplomatik ose shpallja e personit si të papranueshëm;</li> </ul>

	<p>* Kërkesa për kthim mbrapa të përfaqësuesit diplomatik</p> <p>* Vonesa në dhënien e agreementit për shefin e ri të propozuar të misionit diplomatik, pas deklarimit si 'persona non grata' për shefin paraprak të misionit diplomatik;</p> <p>* Ftohja e marrëdhënieve diplomatike: tërheqja e përkohshme, ulja e nivelit të përfaqësimit, nën gradën e shefit të misionit;</p> <p>* Shkëputja e marrëdhënieve diplomatike</p> <p><b>RASTE STUDIMORE</b></p> <p>- <i>Rasti në lidhje me Personelin Diplomatik dhe Konsullor të Shteteve të Bashkuara në Teheran (Shtetet e Bashkuara kundër Iranit)</i></p> <p>- <i>Statusi ligjor i Grinlandes Lindore (Eastern Greenland) (1933)</i></p>
<b>Java e Dymbëdhjetë:</b>	<p><b>E DREJTA KONSULLORE</b></p> <p>*Hyrje, zhvillimi historik</p> <p>*Vendosja dhe ndërprerja e marrëdhënies konsullore</p> <p>*Funksionet konsullore</p> <p>*Llojet, klasat, dhe rangu i konsujve</p> <p>*Procedura e emërimit</p> <p>*Perfundimi i funksioneve konsullore</p> <p>*Privilegjet dhe imunitetet e përfaqësuesve konsullorë</p> <p>*Konsujtë e nderit.</p>
<b>Java e Trembëdhjetë:</b>	<p><b>SHËRBIMI I JASHTËM I REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b></p> <p>* Trashëgimi i Republikës së Kosovës në konventat ndërkombëtare mbi të drejtën diplomatike dhe konsullore nga RSFJ.</p> <p>* Burimet e brendshme juridike (të Kosovës) të së drejtës Diplommatike dhe Konsullore</p> <p>-<i>Emërimi i Ambasadorëve dhe Konsujve sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës.</i></p> <p>-<i>Ligji për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës;</i></p> <p>-<i>Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplommatik të Kosovës;</i></p> <p>-<i>Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplommatik të Republikës së Kosovës;</i></p> <p>-<i>Ligji për Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplommatike, Konsullore dhe Personelin e Kosovës dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake si dhe personelin e saj;</i></p> <p>-<i>Ligji për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës;</i></p> <p>-<i>Rregullorja për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.</i></p>
<b>Java e Katërbëdhjetë:</b>	<b>DIPLOMACIA EKONOMIKE DHE DIPLOMACIA E BASHKIMIT</b>



	<b>EVROPIAN</b> * Shërbimi i Jashtëm i Bashkimit Evropian * Nocioni dhe Zanafilla * Funksionet e diplomacisë ekonomike * Diplomacia ekonomike në marrëdhëniet bilaterale * Diplomacia ekonomike pranë organizatave ndërkombëtare.
<b>Java e Pesëmbëdhjetë:</b>	<b>Përgatitje për provim përfundimtar!</b>

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<b><i>Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UP-së.</i></b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Studentët pritet të marrin pjesë rregullisht në ligjërata;</li> <li>■ Prezenca e studentëve do të regjistrohet në listat e pjesëmarrjes, ku studentët do të vendosin firmën e tyre duke konfirmuar praninë e tyre;</li> <li>■ Pjesëmarrja aktive e studentëve do të vlerësohet në baza të pjesëmarrje aktive nëpërmjet interaktivitetit me Profesorin e lëndës dhe studentët e tjerë, prezantimin e temave të ndryshme dhe individuale dhe grupeve të punës ku ata mund të caktohen;</li> <li>■ Studentët do të kenë qasje në planin mësimor në javën e parë të semestrit ku do të familjarizohet me literaturën, si atë bazë, poashtu edhe atë dhe rekomanduar;</li> <li>■ Studentët janë të inkurajuar për të ngritur çështje të ndryshme për diskutim në lidhje me objektivat dhe qëllimin e lëndës;</li> <li>■ Studentët nuk janë të lejuar të ngrisin çështje të cilat nuk korrespondojnë me lëndën mësimore.</li> <li>■ Pushimet gjatë ligjëratave do të vendosen së bashku me studentët për t'i akomoduar sa më mirë nevojat e tyre.</li> </ul>	